



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr: Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [ëëë.uni-pr.edu](http://ëëë.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 297

Prishtinë, Dt. 30.01.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS  
MASTER

FAKULTETI	I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE (FSHMN)
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI/GJEOGRAFI
Tema e diplomës master	<b>Shpërfaqja e identitetit regjional në trevën e Rugovës</b>  (ang: Expression of regional identity in the Rugova Region)
Kandidati	<b>Shkumbin Lushaj</b>
Mentori	Prof. Dr. Arsim Ejupi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 01.06.2023 Vendimi nr.: 2433

Në bazë të kërkesës së kandidatit **Shkumbin Lushaj** (dt.15.01.2024, ref.nr.:98) dhe me lejen e mentorit të temës, komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të temës master në përbërje: Prof. asoc, Valbon Bytyqi, Prof.dr. Arsim Ejupi dhe Prof.asoc.dr. Ferim Gashi, paraqet këtë:

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT**

Punimi i diplomës master me titull "**Shpërfaqja e identitetit regjional në trevën e Rugovës**" i kandidatit **Shkumbin Lushaj** është punë shkencore-hulumtuese e realizuar me përdorimin e një qasje specifike teoriko-metodologjike, ku janë përfshirë, leximi dhe vështrimi kritik i literaturës, dalja dhe vrojtimit në terren, gjatë të cilit janë identifikuar elementet për diferencimin regjional, sikurse që janë veçuar tiparet e identitetit regjional të hapësirës së studimit. Gjatë kësaj faze poashtu është realizuar edhe plotësimi i pyetësorit, i përgatitur enkas për qëllimet e këtij hulumtimi, ku përmes përgjigjeve të responentëve janë marrë qëndrimet e tyre mbi perceptimin dhe praninë e tipareve të identitetit regjional në trevën e Rugovës.

Dorëshkrimi është i strukturuar në 3 kapituj kryesorë, të cilëve i paraprijnë abstrakti, hyrja, qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia e punës. Qëllimi i hulumtimit ka qenë që të konstatohen faktorët determinues natyrorë, historikë dhe socialë-ekonomikë si dhe ndikimin e tyre në praninë dhe shpërfaqjen e identitetit regjional në zonën e studimit.

Për një problem studimor ndërdisiplinar çfarë është identiteti regjional, kandidati ka bërë një vështrim kritik të literaturës duke përmendur autorët kryesorë të cilët merren si pionierë dhe autoritete në trajtimin teoriko-metodologjik dhe shkencor të regjionit dhe identitetit regjional si Passi, Terlouw, Pohl, Bally, Robinson, etj. Në këtë mënyrë kandidati ka arritur që të ofroj prova të cilat dëshmojnë se përveç tjerash identiteti në përgjithësi dhe identitet regjional në veçanti është problem studimor edhe i gjeografisë, në veçanti i asaj regjionale. Në këtë pjesë kandidati përmend dhe analizon kontributet e autorëve vendorë të cilët kanë bërë hulumtime për këtë trevë në aspekte të ndryshme studimore sikurse, Krasniqi, Islami, Çavolli, Pllana e të tjerë.

Në kapitullin e parë kandidati jep një shumësi të definicioneve mbi regjionin si kategori dhe regjionalizimin si proces, duke i kontekstualizuar me objektin dhe hapësirën e përzgjedhur të studimit. Poashtu në mënyrë kronologjike përshkruan evoluimin e identitetit si koncept studimor, duke vënë në pah karakterin shumëdisiplinar që ka ai. Të gjitha trajtesat brenda këtij kapitulli shoqërohen me citime dhe referenca bibliografike duke dëshmuar korrektësinë shkencore dhe autenticitetin e punës së bërë. Në nënkapitullin 1.2 kandidati jep shembuj të identiteteve regjionale nëpër vende të ndryshme të Europës duke analizuar specifikat dhe faktorët përcaktues të cilët kanë bërë të mundur krahasimin me objektin dhe hapësirën e përzgjedhur për studim.

Në kapitullin e dytë kandidati në fillim përshkruan shtrirjen, madhësinë dhe pozitën gjeografike të zonës së studimit, pastaj analizon kushtet natyrore dhe tiparet e pejzazhit. Këtu përfshihen të dhënat mbi ndërtimin gjeologjik dhe tiparet dominuese të relievit në këtë treve; veçoritë e klimës, duke përmendur elementet kryesorë klimatike të cilët më së shpeshti përdoren për të përcaktuar tiparet e klimës së ndonjë krahine apo regjioni; hidrografinë me praninë dhe specifikat e trupave ujorë; botën bimore dhe shtazore të cilët dalin të kenë luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën e jetesës ku përfshihen aktivitetet ekonomike, vendbanimet, mënyra e ndërtimit të shtëpive, veshëmbathja, raportet shoqërore, doket dhe traditat. Në kapitullin 2.4 kandidati ofron të dhëna të vlefshme mbi historikun e trevës së Rugovës, duke përmendur procese, ngjarje a figura të cilat ndërlidhen me të kaluarën historike dhe rrugëtimi e derisotshëm të kësaj treve. Në nënkapitujt e radhës jipen të dhënat kryesore demogjeografike për këtë trevë me elementet kryesore të regjimit demografik, ndryshimin e numrit të popullsisë nëpër periudha të ndryshme kohore e deri te lëvizja hapësinore e popullsisë e cila është shprehur përmes proceseve të intensifikuara emigruese që kanë arritur deri në nivelet e shpopullimit. Kandidati, gjithmonë duke ju referuar botimeve relevante shkencore përmend gjithësej 13 vendbanimet që historikisht i takojnë kësaj treve etnografike, e të cilat janë autentike për nga stili i ndërtimit të shtëpive, materialet, mënyra e organizimit të aktiviteteve brenda oborrit ekonomik familjar, etj. Në kapitullin e tretë dhe të fundit analizon rezultatet e fituara nga pyetësi, ku përmes përgjigjeve të ndryshme arrin të etablojë konstatimet mbi praninë dhe shpërfaqjen e identitetit regjional. Pjesën tekstuale e shoqëron një databazë e pasur e të dhënave gjeostatistikore, hartave, ilustrimeve, fotografive të terrenit që bëjnë të mundur kuptimin dhe transmetimin më të qartë të përmbajtjes së temës.

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Nga vlerësimi i dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit **Shkumbin Lushaj**, me titull “**Shpërfaqja e identitetit regjional në trevën e Rugovës**” mund të përfundojmë se problemi i përzgjedhur për hulumtim është i ri dhe i patrajtuar më parë në këtë format, në literuarën gjeografike profesionale dhe shkencore, duke ofruar një shteg të ri për hulumtime më të thelluara dhe të specializuara në të ardhmen. Të dhënat e përfituara nga vrojtimet në terren janë përdorur me kujdes për të mbështetur qëndrimin apriori në formë hipoteze për praninë dhe shpërfaqjen e identitetit regjional, kurse janë shoqëruar me të dhëna të shumta gjeostatistikore, tabela, ilustrime harta e fotografi. Nga përpunimi i rezultateve të pyetësorit është konstatuar prania e elementeve të ndryshme të identitetit regjional, në radhë të parë nëpërmjet qëndrimeve dhe perceptimeve të banorëve të kësaj ane mbi përkatësinë regjionale dhe elementeve kyçe natyrore, kulturore, historike, e sociale që formësojnë tiparet e identitetit regjional.

Duke u mbështetur në vlerësimet dhe përfundimet e mësipërme, komisioni profesional-shkencor është i mendimit se punimi i diplomës master i kandidatit **Shkumbin Lushaj**, me titull “**Shpërfaqja e identitetit regjional në trevën e Rugovës**” i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për të kaluar në procedim të mëtutjeshëm.

Prishtinë, 30.01.2024

Komisioni:

1. Prof.asoc. dr. Valbon Bytyqi, kryetar

  
2. Prof.dr. Arsim Ejupi, anëtar

  
3. Prof.asoc. dr. Ferim Gashi, anëtar